



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

SSH.07 STANDARDET E ADMINISTRATES DHE FINANCES

SSH.07.01 Standardi i parimeve të përgjithshme të politikës shtetërore për financimin e UPT

UPT duhet të funksionojë sipas parimit të autonomisë financiare.

Të ardhurat e krijuara nga UPT duhet të përdoren tërësisht prej tij dhe pjesa e papërdorur e tyre të mbartet në vitin pasardhës.

Transferrat e pakushtëzuara, që Buxheti i Shtetit akordon në vitin buxhetor pasardhës për UPT, duhet të përcaktohen duke marrë në konsideratë edhe pjesën e këtyre transfertave që do të mbarten nga viti paraardhës.

Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre duhet të bëhen në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimin financiar publik.

Në përdorimin e burimeve financiare përparësi duhet të kenë të ardhurat e veta, të cilat do të shpenzohen në përputhje me procedurat e buxhetit afatmesëm.

Të gjitha transaksionet e arkëtimeve, përfshirë dhe të ardhurat e veta, si dhe ato të pagesave të UPT duhet të kryhen nëpërmjet sistemit të thesarit, duke respektuar të gjitha rregullat e kontrollit financiar, të përcaktuara sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Këshilli i Ministrave, përmes MASH dhe opinionit publik kanë të drejtë të kërkojnë transparencë të plotë për përdorimin e këtyre të ardhurave dhe financimeve nga Buxheti i Shtetit. Ky informacion duhet të përfshihet në raportin vjetor të UPT, që i dërgohet Ministrisë së Financave dhe MASH dhe duhet të bëhet publik.

SSH.07.02 Standardi i burimeve të financimit të UPT

UPT duhet të financohet nga:

- a) transfertat nga Buxheti i Shtetit;
- b) të ardhura të krijuara nga UPT;
- c) burime të tjera me destinacion.

Këshilli i Ministrave, përmes MASH, duhet t'i japë UPT fonde për përmbushjen e misionit të tij sipas standardeve.

UPT duhet të bëjë rregulloren e tij mbi mënyrën e përdorimit të fondeve të krijuara nga të ardhurat, duke respektuar rregullat financiare të përcaktuara nga ligjet e shtetit.

SSH.07.03 Standardi i të ardhurave të UPT

Në të ardhurat e UPT duhet të përfshihen:

- a) tarifatat e studimeve, të cilat janë të diferencuara sipas cikleve, formave të studimeve etj.;
- b) të ardhura nga organizimi i trajnimeve ose kualifikimeve për të tretë, sipas marrëveshjeve të lidhura;
- c) të ardhura nga kryerja e punimeve kërkimore të porositura dhe shërbimeve të tjera të specializuara;
- d) të ardhura që krijohen nga dhënia e aktiveve në përdorim të palëve të treta në trajtën e kontratave të qiradhënies dhe me forma të tjera kontraktimi;
- dh) dhuratat, trashëgimitë dhe donacionet publike;
- e) financimet e pakthyeshme, të marra nga burime të huaja në kuadrin e projekteve dy e shumëpalëshe;
- ë) financime të tjera të ligjshme, të marra nga burime të ndryshme.

Të ardhurat e mesiperme duhet të derdhen 100 për qind në llogarinë e UPT dhe duhet të përdoren nga vetë ai, sipas rregullave të përcaktuara.

SSH.07.04 Standardi i tarifave

Tarifatat e studimeve duhet të përfshijnë tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit.

Tarifatat e regjistrimit për të gjitha programet e studimeve duhet të propozohen nga UPT dhe të miratohen nga MASH.

Tarifa e shkollimit për ciklin e parë për sistemin e studimeve me kohë të plotë, ciklin e dytë dhe ciklin e tretë të studimeve duhet të vendoset nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në propozimin e MASH. Kjo e

fundit duhet të marre edhe mendimin e Konferencës së Rektorëve dhe Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës.

Tarifat e shkollimit për ciklin parë për sistemin e studimeve me kohë të pjesshme dhe në distancë duhet të propozohen nga UPT. Kjo tarifë duhet të caktohet me urdhër të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrit të Financave.

Tarifa e shkollimit në çdo rast nuk mund të kalojë vlerën e kostos së studimeve.

Studentët e shkëlqyer nuk duhet të paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

SSH.07.05 Standardi i financimit nga Buxheti i Shtetit

Transferta nga Buxheti i Shtetit për UPT duhet të jepen në formë granti, që duhet të përdoret sipas këtyre kategorive:

- a) transfera e pakushtëzuar;
- b) transfera me konkurrim për investime.

Transferta e pakushtëzuar duhet të përdoret për financimin e shpenzimeve që lidhen me funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe për financimin e investimeve me karakter të vazhdueshëm.

Transferta me konkurrim për investime duhet të përdoret për financimin e investimeve me karakter ndërtimi dhe projekte të tjera të mëdha, sipas klasifikimit në procedurat për menaxhimin e investimeve publike dhe për kërkim shkencor.

SSH.07.06 Standardi i shpërndarjes së financimit nga Buxheti i Shtetit

Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar duhet të bazohet në një formulë që garanton barazi, drejtësi dhe transparencë. Kriteret dhe komponentët e formulës duhet të përcaktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në konsultim me Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe miratohen në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit.

Shpërndarja e grantit konkurrues për investime duhet të bëhet mbi bazën e projekteve që paraqiten nga UPT, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin vjetor të buxhetit.

Struktura e hartimit të buxhetit për UPT duhet të bëhet sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

SSH.07.07 Standardi i hartimit të buxhetit të UPT

Projektbuxheti i UPT duhet të hartohet nga rektorati, duke u mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 3-vjeçar dhe në propozimet e ardhura nga strukturat përbërëse të UPT, si dhe miratohet nga senati akademik, pasi miratohet prej këshillit të administrimit. Hartimi i buxhetit bëhet në përputhje me standardet e vendosura nga Ministria e Financave. Projektbuxheti i përcillet MASH, i cili brenda 30 ditëve duhet të ushtroje kontrollin që i takon sipas ligjit në formën e kërkesës së motivuar për rishikim.

UPT duhet të detajojnë dhe të miratojnë buxhetin e tij vjetor sipas rektoratit, fakulteteve, departamenteve, qendrave kërkimore dhe njërive të tjera të njëvlershme me to, sipas statutit dhe rregulloreve të tij. Të gjitha këto njësi duhet të jenë autonome në administrimin e buxhetit të tyre, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

SSH.07.08 Standardi i rregullave të administrimit dhe raportimit financiar

Rregullat e administrimit financiar të UPT duhet të jenë të njëjta me ato të institucioneve të tjera publike.

SSH.07.09 Standardi i pronave të paluajtshme të UPT

Pronat e paluajtshme publike, të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë, duhet të kalojnë në administrim të UPT me vendim të Këshillit të Ministrave dhe propozim të MASH.

UPT duhet të mirëmbajë dhe të përdore për interesa të institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pronat e paluajtshme publike që i janë lënë në administrim. Ato duhet të hipotekohen në pronësi të shtetit për përdorim nga UPT.